



1. Muhammedi, alejhi selam, ka thënë: “Kush e takon Allahun duke mos i bërë shirk në asgjë, do të hyj në Xhenet.” (Transmeton Buhariu)

2. Muhammedi, alejhi selam, ka thënë: “Kush beson në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij, e fal namazin, e agjëron ramazanin ka të drejt tek Allahu që ta futë në Xhenet.” (Transmeton Buhariu)

3. Muhammedi, alejhi selam, ka thënë: “Kush ndërton një xhami, duke e kërkuar kënaqësinë e Allahut, Allahu ia ndërton atij një te ngjashme në Xhenet” (Transmeton Buhariu)

4. Muhammedi, alejhi selam, ka thënë: “Kush e fal sabahun dhe ikindinë do të hyj në Xhenet”. (Transmeton Buhariu)

5. Muhammedi, alejhi selam, ka thënë: “Kush shkon në xhami apo kthehet nga ajo Allahu ia përgatit atij një shtëpi në xhenet sa herë që shkon dhe kthehet.” (Transmeton Buhariu)

6. Muhammedi, alejhi selam, ka thënë: “Kush ma garanton mua gjuhën dhe organin (gjenital) e tij, Unë ia garantoj atij Xhenetin.” (Transmeton Buhariu)

7. Muhammedi, alejhi selam, ka thënë: “Kush i falë 12 rekate brenda ditës, do t'i ndërtohet një shtëpi në Xhenet.” (Transmeton Muslimi)

8. Muhammedi, alejhi selam, ka thënë: “Kush niset në rrugë që të kërkoj dituri, Allahu do t'ia lehtësojë me të rrugën për në Xhenet.” (Transmeton Muslimi)

9. Muhammedi, alejhi selam, ka thënë: “Nëse muezini thotë: Allahu Ekber-Allahu Ekber, e dikush nga ju thotë: Allahu Ekber-Allahu Ekber... (Pastaj e ka përmendur ezanin)... pastaj (muezini) thotë: Hajje ales-slah, e dikush nga ju thotë: La havle ve la kuvvete il-la bil-lah. Pastaj

(muezini) thotë: Hajje alel felah. E dikush nga ju thotë: La havle ve la kuvvete il-la bil-lah... e pastaj(muezini) thotë: La ilahe il-IAllah. E përcjellsi nëse thotë: La ilahe il-IAllah me zemër te singert, do të hyj në Xhenet.” (Transmeton Muslimi)

10. Muhammedi, alejhi salam, ka thënë: “Çdo Musliman i cili merr abdest dhe e plotëson atë, e pastaj ngritet dhe i falë dy rekate me përkushtimin e zemrës dhe fytyrës së tij, i obligohet atij Xheneti”. (Transmeton Muslimi)

11. Muhammedi, alejhi salam, ka thënë: “Kush thotë jam i kënaqur me Allahun-Zot, Islamin si fe dhe Muhammedin, alejhi salam, si të Dërguar do të hyj në Xhenet.” (Transmeton Ebu Davudi)

12. Muhammedi, alejhi salam, ka thënë: “Vërtetë singëriteti të çon në bamirësi, dhe bamirësia të çon në Xhenet.” (Transmeton Buhariu)

13. Muhammedi, alejhi salam, ka thënë: “Ai i cili viziton ndonjë të sëmur apo një vëlla për hir të Allahut, do të hyj në Xhenet”. (Transmeton Tirmidhiu)

14. Muhammedi, alejhi salam, ka thënë: “O ju njerëz, shpërndajeni selamin, jepni ushqime dhe faluni kur njerëzit flejnë, do të hyni në Xhenet.” (Transmeton Tirmidhiu)

15. Muhammedi, alejhi salam, ka thënë: “Umreja mes umres është falje gjynahesh mes tyre, dhe Haxhi i pranuar nuk ka shpërblim tjetër pos Xhenetit”. (Transmeton Buhariu)

16. Muhammedi, alejhi salam, ka thënë: “Me të vërtetë Allahu ka 99 emra e kush i mëson (i vërteton dhe përfiton nga përmbajtja e tyre), do të hyjë në Xhenet.” (Transmeton Buhariu)

17. Muhammedi, alejhi salam, ka thënë: “Kam parë një njeri në Xhenet për shkak se kishte hjekur nga rruga një therrë që pengonte besimtarët.” (Transmeton Muslimi)

18. Muhammedi, alejhi salam, ka thënë: “O Allah, Ti je Zoti im, nuk ka të adhuruar tjetër përveç Teje; Ti më ke krijuar dhe unë jam rob i Yt, do të qëndroj besnik ndaj mar-rëveshjes dhe premtimit Tënd, me sa të kem mundësi; Kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja që kam vepruar. Unë jam mirënjohës ndaj dhuntive të Tua, i pranoj mëkatet e mia, prandaj më fal, sepse mëkatet nuk mund t'i fali askush tjetër përveç Teje”. Ka thënë: “Kush e thotë gjatë ditës me bindje në të, e nëse vdes gjatë ditës para së të ngrysë, ai do të jetë nga banorët e xhenetit, e nëse e thotë gjatë natës i bindur në të, e vdes para se të gdhijë, ai do të jetë nga banorët e Xhenetit.” (Transmeton Buhariu)

Përktheu : Valdet Kamberi